

VENDIM
Nr. 414, datë 15.5.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 327, DATË 29.4.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KALIMIN NË FOND BANESE TË ISH-OBJEKTEVE TË DALA NGA RISTRUKTURIMI I
MINISTRISË SË BRENDSHME (REPARTIT USHTARAK NR. 5715), “KODRA E PRIFTIT”,
TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMIN, NË EMËR TË BANORËVE, NGA ENTI KOMBËTAR I
BANESAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve”, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore” dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr. 327, datë 29.4.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Pas kalimit të këtyre objekteve në fond banesash dhe regjistrimit të tyre në ZVRPP-në e Tiranës, Enti Kombëtar i Banesave ngarkohet të lidhë pa kundërshtpërblim (vlerën e objektit dhe trullit funksional) kontratat e privatizimit me banorët e pastrehë, të përcaktuar në listat emërore sipas familjeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Shpenzimet operationale të Entit Kombëtar të Banesave dhe shpenzimet hipotekore të përballohen nga përfituesit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMËRORE E ISH-PUNONJËSVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK QË BANOJNË
NË OBJEKTET E ISH-REPARTIT USHTARAK NR. 5715
TE “KODRA E PRIFTIT”, TIRANË

Nr. emër, mbiemër, nr. i godinës	Nr. emër, mbiemër, nr. i godinës
1. Viktor Hysaj 2	23. Nuredin Dervishi 6
2. Fatmir Leli 2	24. Abaz Balla 6
3. Hasan Pashai 14	25. Perlat Leli 7
4. Arben Hasani 14	26. Arben Alikaj 7
5. Vladimir Bisha 14	27. Ziadet Llanaj 7
6. Ylli Myslimaj 14	28. Ndoc Çardaku 7
7. Sadri Ymaj 3	29. Bujar Dusha 7
8. Petrit Lamnica 3	30. Isyf Kateshi 8
9. Ndriçim Tomorri 4	31. Naim Spahiu 8
10. Edmond Domi 1	32. Naim Sinani 8
11. Sherif Quku 1	33. Artur Gajtani 8
12. Bedri Mersini 1	34. Xhevdet Guga 8
13. Gëzim Shaholli 1	35. Bislim Berisha 8
14. Shkëlqim Hasani 1	36. Jashar Bakiasi 8
15. Xhavit Zyka 1	37. Pirro Davidhi 8
16. Vido Prifti 1	38. Mihallaq Çuko 8
17. Fatos Çausi 1	39. Bashkim Selimi 8
18. Vlash Buna 1	40. Sejdin Lloci 8
19. Tanush Arapi 1	41. Mersin Maknori 8
20. Gëzim Haxhisi 6	42. Fadil Elezi 8
21. Xhevdet Hyka 6	43. Sejfulla Maxhelaku 11
22. Durim Harizi 6	44. Besnik Zela 12